


→ Qyteti im

falas



Botim i Bashkisë Korçë Nr. 3, PRILL 2008

Buxheti i Bashkisë Korçë 2008
Panairi i Poçerisë
Ambasadori Lohan viziton Korçën



KORÇA KU
DUA TE JETOJ

Buxheti i Bashkisë Korçë 2008

Buxheti

856 933 000 lekë

Cilat janë parimet e Buxhetit Bashkiak për 2008-ën ?

- Shumëllojshmëria e burimeve të të ardhurave
- Garantimi për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur
- Transferimi i fondeve të nevojshme nga pushteti qendror për pushtetin vendor për përmbushjen e të gjitha standardeve dhe kërkesave që vendos për funksionet e deleguara
- Buxheti paraqitet i balancuar (pa defiçit) të ardhurat = shpenzimet
- I besueshëm
- Gjithëpërfshirës dhe në koherencë me nevojat e qytetarëve

Buxheti i përgjithshëm i Bashkisë Korçë dhe Institucioneve të Vartësisë për vitin 2008 shkon në vlerën 856 933 000 lekë, pra 31.8 % më shumë se realizimi i buxhetit për vitin 2007, ose 206 738 000 lekë më shumë.

Projektet prioritare

Bashkia e Korçës, për vitin 2008 ka planifikuar një fond prej 12 173 000 lekësh për realizimin dhe implementimin e 37 projekteve prioritare, në kuadrin e 7 programeve që Bashkia do të realizojë për 2008-ën me synimin gjallërimin dhe rritjen e cilësisë së jetës tek komuniteti si dhe zhvillimin e turizmit.

Granti i Qeverisë 33.79% më shumë

Viti 2007	108 557 mijë lekë
Viti 2008	149 605 mijë lekë




Ku shkojnë të ardhurat ?

Tendenca kryesore është rritja e investimeve kapitale për shërbimet publike ndaj komunitetit

→ Si ndahen shpenzimet ?

- Subvencione 0.4%
- Transferta 1.5%
- Fond rezervë 1%
- Kontributi i qarkut 0.7%
- Ndihma ekonomike 25%
- Shpenzime për pagat 16.8%
- Shpenzime për sigurimet shoqërore 3.5%
- Shpenzime operative 28.2%
- Investime 23.2%



Buxheti 2008 në mbledhjen e Këshillit Bashkiak

“Buxheti që na është paraqitur për miratim është transparent në kuptimin e destinacionit të shpenzimeve. Aty dallohet qartë se ku do të shkojnë të ardhurat. Është shumë i guximshëm i krahasuar me atë të vitit të kaluar, 31,8 % më shumë të ardhura se realizimi i 2007-ës. Njëkohësisht ky buxhet është legjitim pasi i referohet procesit të Buxhetimit me pjesëmarrje dhe për çdo pjesë i referohet legjislacionit në fuqi, njëkohësisht ai ka përmirësim të strukturës së shpenzimeve në drejtim të shërbimeve publike”

“E vlerësoj punën dhe përpjekjet e specialistëve të Bashkisë për të na dhënë një buxhet sa më të arrirë. Por kjo na motivon edhe më tepër për të kontribuar edhe ne me vërejtjet tona për ta bërë këtë buxhet edhe më të arrirë. Vlerësojmë analizën zë për zë që i është bërë atij. Gjykojmë se ndërtimi i Zonës Këmbësore nuk është kaq i rëndësishëm sa na paraqitet mbase kërkon më tepër transparencë dhe një referendum lokal për ndryshimin e destinacionit. Njëkohësisht duhet të shihet me kujdes kontributi që Bashkia i detyrohet Këshillit të Qarkut, masa e këtij kontributi është përcaktuar me udhëzimet përkatëse”



Olsi Ekonomi - Kryetar i grupit të këshilltarëve të majtë



Pëllumb Beqiri - Kryetar i grupit të këshilltarëve të djathtë

Investime

Investime

Kanë përfunduar dy investime të rëndësishme në infrastrukturën e qytetit. Bëhet fjalë këtu për dy rrugë mjaft problematike të qytetit Riza Cerova dhe Xhafer Cenko Lubonja, të cilat ishin mjaft të amortizuara për shkak të mungesës së investimeve në to prej vitesh. Këto dy rrugë, janë investime të nisura nga viti i kaluar dhe po realizohen me fonde nga buxheti i shtetit. Nga ana tjetër ritmet për ndërtimin e shkollës së re 9-vjeçare janë mjaft premtuese pasi kontrata para-

shikon që punimet të mbyllen në dhjetor të 2008-ës dhe deri tani janë kryer më shumë se 80 % të punimeve.

Ndërkohë investimet e këtij viti kanë nisur me sistemim-asfaltimin e Rrugës 10- Korriku (tek Qendra Sanitare), me fondin prej 14 milion lekësh nga buxheti i shtetit. Në këtë segment parashikohet të kryen kanalizime, trotuare e asfaltime, punime të cilat i ka marrë përsipër firma "Simaku".





Fushata **Mjedisi** sensibilizuese “Për një Korçë më të pastër”

Bashkia Korçë ka hartuar planin e veprimit për fushatën sensibilizuese “Për një Korçë më të pastër”. Kjo fushatë përfshin aktivitete të ndryshme në mbrojtje të mjedisit si “Ne jemi pjesë e tokës” në kuadrin e ditës së tokës, “Për një Korçë më të pastër” në kuadrin e ditës së mjedisit etj; një sërë iniciativash promovionale ku përfshihen publikimi i rregullores së pastrimit, spote publicitare në TV etj; një sërë investimesh në rrugë, lulishte, vendosjen e koshave në rrugët kryesore në qytet si dhe vendosjen e masave shtënguese. Bashkia u bën thirrje të gjithëve të japin kontributin e tyre për një mjedis më të pastër duke zbatuar detyrat e gjithsecilit në komunitet. Pritja e vetëdijes dhe përgjegjësisë qytetare për mbrojtjen e mjedisit në përputhje me iniciativat e ndërmara nga Bashkia në këtë drejtim do ta kthejnë Korçën në qytetin ku ne duam të jetojmë.

Lulishtja në krah të stadiumit kthehet në identitet

Me objektivin për kthimin e sipërfaqeve të gjelbra në identitet, lulishtja në krah të stadiumit, pjesë e “Parkut Rinia”, ka filluar të ndryshojë pamje. Lulishtja e cila për vite me radhë është degraduar plotësisht filloi të kthehet në normalitet në sajë të punës së Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike e cila po e riaftëson këtë territor duke mbjellë pemë e bar, duke zëvendësuar bordurat e duke krijuar rrugicat për të vazhduar më tej me vendosjen e stolave çlodhës dhe ndriçimin. Lulishtja, edhe për shkak të afërsisë me stadiumin, do t’i shërbejë jo vetëm komunitetit të kësaj zone për të kaluar orë çlodhje e argëtimi, por gjithë qytetarëve të Korçës.

Gjatë këtij viti, Bashkia ka riaftësuar e kthyer në identitet tre lulishte të tjera si lulishtja tek Birra Korça, lulishtja në krah të Stadiumit “Skënderbeu” (pjesë e Parkut Rinia) si dhe lulishtja në unazë të qytetit.

Për më tepër sipërfaqet mes pallateve dhe lagjeve po konturohen nga Bashkia e Korçës për t’u kthyer në sipërfaqe të gjelbëruara, çlodhëse dhe argëtuese.



Mirësevini në Korçë!

Korça është njohur si qyteti i kulturës, traditës dhe peizazhit. Por tani Korça do të njihet dhe si qyteti i festave, qyteti ku ju mund të kaloni një fundjavë të paharrueshme. Bashkia e qytetit publikoi të parin kalendar aktivitetesh, një guidë evenimentesh në dorën e qytetarëve të Korcës e vizitorëve të shumtë të saj. Kalendar i sezonit festiv pasqyron të gjitha aktivitetet kulturore, artistike, festat apo

panairot që do të organizohen përgjatë periudhës Prill-Dhjetor 2008.

Ne ju ftojmë të gjithëve të vini dhe të shijoni atmosferën festive në qytetin e serenatave, karnavaleve, birrës më të famshme në të gjithë Shqipërinë! Mirësevini në Korçë!

Ne jemi pjesë e Tokës



22 prilli është dita që bashkon të gjitha kombet, shtetet dhe banorët në rruzullin tokësor, me një qëllim të vetëm: "Përkushtimin për ruajtjen e harmonisë së natyrës kundrejt zhvillimeve të teknologjisë"

Këtë mesazh e përcolli Bashkia e qytetit në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore, Senation Rinor dhe kontributin e Korsel e Konstruksion '93, përmes zërit dhe punimeve të fëmijëve, e konceptuar në formën e një konkurimi me nxënësit e shkollave 9-vjeçare të qytetit. Punimet e nxënësve me materiale të riciklueshme spikatën për larminë tematike, forcën e mesazheve të përcjella të gjitha me qëllimin e vetëm, ndërgjegjësimin e qytetarëve, kryesisht të rinjve rreth problemeve të tokës dhe mënyrave të ndryshme për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Ky aktivitet ishte i pari në kuadrin e fushatës sensibilizuese për mbrojtjen e mjedisit që do të pasohet me një sërë aktivitetesh të tjera. Juria vlerësoi të gjitha punimet e paraqitura dhe përkushtimin e nxënësve. Me çmim të parë u vlerësuan nxënësit e shkollës Sotir Gura. Për të gjitha shkollat pjesëmarrëse u ndanë çertifikata si dhe në mënyrë simbolike 4 kosha për hedhjen e mbeturinave për secilën shkollë.





Turizmi – një ndër prioritetet e Bashkisë



Turizmi është konsideruar vazhdimisht si një ndër prioritetet e Bashkisë së qytetit. Pavarësisht aktivitetetve të ndryshme me qëllim nxitjen e turizmit në qytetin tonë deri më tani në Bashki kishte munguar një strukturë për promovimin e qytetit apo një plan veprimi për turizmin, duke ia lënë gjithcka spontanitetit. Me strukturën e re filloi funksionimi i zyrës për Marketingun e qytetit dhe Zhvillimin e Turizmit që në bashkëpunim me SNV po harton strategjinë lokale për zhvillimin e turizmit. Në këtë kuadër gjatë muajit mars u organizua një takim me të gjithë aktorët lokalë në fushën e turizmit ku u bë një prezantim i iniciativave të ndërmarra si dhe i planeve në të ardhmen në fushën e turizmit nga Bashkia, Qarku, Universiteti, Dhoma e Tregëtisë, biznesi, GTZ, EDEM si dhe u krijua Komiteti për Zhvillimin e Turizmit. Në 7, 8 dhe 9 Prill, ky komitet me mbështetjen e SNV, hartoi plan-veprimin për zhvillimin e turizmit, një dokument të rëndësishëm për zhvillimin e qytetit në këtë drejtim. Plan-veprimi për turizmin, pasi të prezantohet në Këshillin Bashkiak dhe të marrë miratimin e tij do të jetë i hapur për sugjerime dhe ide nga opinioni publik.

Panairi i Poçerisë

Në datat 25 dhe 26 Prill, në sheshin para Katedrales “Ngjallja e Krishtit”, Bashkia Korçës organizoi Panairin e Parë Ndërrajonal të Poçerisë.

Duke synuar rigjallërimin e traditës së vjetër korçare të punimit të baltës, ky panair bashkoi prodhues të ndryshëm që ekspozuan apo tregëtuan produktet e tyre. Ndër të tjera, pjesëmarrëse në këtë panair ishte dhe Prefektura e Follorinës, Greqi. Panairi do të kthehet në një aktivitet të përvitshëm për qytetin duke synuar nga viti në vit rritjen e numrit të pjesëmarrësve.



Vizita

Ambasadori Lohan viziton Korçën

Projektet për zhvillimin e turizmit historik e kulturor përbëjnë një mundësi që qyteti ynë të nxjerrë në pah avantazhet e veta konkurruese. Projektet madhore si ndërtimi i zonës këmbësore, rivitalizimi i pazarit të vjetër, ngritja e Muzeut të ri të Artit Mesjetar, ngritja e universitetit të ri janë atraksion për qytetin ndaj kemi alokuar të gjitha energjitë tona në këto fusha. Kështu e ka prezantuar vizionin e Bashkisë Kryebashkiaku i Korçës, Niko Peleshi, gjatë vizitës së Ambasadorit të Komunitetit European Helmut Lohan.

“Korça ka një histori të rëndësishme dhe padyshim ka përpara

një të ardhme të shkëlqyer. Janë 1 milion euro të Komunitetit European për Shqipërinë për projekte në fushën e trashëgimisë kulturore të cilat do të përzgjidhen nga ekspertët e zyrës”, - është shprehur Lohan duke marrë me vete një kopje të projektit të pazarit të vjetër të Korçës.

Ambasadori Lohan tregoi interes edhe për ngritjen e Universitetit privat në Korçë duke vlerësuar në veçanti ngritjen e qendrave për arsimimin profesional të të rinjve, e cila është e lidhur ngushtë me zhvillimin ekonomik të qytetit.



Banka Europiane e Investimeve, mundësi financimi në infrastrukturën e qytetit

“Ne kerkojme një impakt të menjehershëm e të shpejtë, gjë e cila do të sillte një qytet të rindërtuar nga pikëpamja e infrastrukturës, me një cilësi më të spikatur jete që do të thotë më tepër besim për qytetarët që është e para gjë që duhet të bëjmë”

Niko Peleshi

Suksesi i projekteve madhore të zbatuara në qytetin tonë siç janë ai i ujësjellësit dhe kanalizimeve të financuara nga donatorë të fuqishëm, KFW dhe Banka Europiane e Investimeve, kanë sjellë sërish këta të fundit në Korçë me vullnetin dhe bindjen për të investuar. Gjatë takimit të zhvilluar në Bashkinë e Korçës përfaqësuesit e kësaj Banke kanë diskutuar mjaft mundësi financimi. Biseda është fokusuar në zhvillimin e projektit të rigjenerimit dhe rehabilitimit të njëkohshëm për të gjitha rrugët dhe lulishtet e qytetit. Të dy palët kanë ndarë vizionin se Korça kërkon një rigjenerim total në një kohë të shkurtër.

Projekti i Bashkisë Korçë, për rehabilitimin e të gjitha rrugëve e lulishteve, të cilat përfshijnë një sipërfaqe totale prej 700 mijë m², është kërkuar për t'u marrë menjëherë në shqyrtim nga Zyra e Bankës Europiane të Investimeve.

Për Kryetarin e Bashkisë Niko Peleshi, ky takim është konsideruar si një nga më të suksesshmit gjatë mandatit të tij.

Nxënësit e klasës së parë – këshilltarë për një ditë!

Kurioziteti dhe dëshira për t'u njohur me institucionin kryesor që drejton qytetin e Korçës, i ka nxitur nxënësit e tre klasave të para të Shkollës Greke "Omios" të qytetit të vizitojnë Bashkinë. Pasi janë shoqëruar nga punonjës të bashkisë në disa nga zyrat e këtij institucioni, Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi u ka rezervuar atyre një pritje të veçantë në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Nga kjo sallë ai u ka shpjeguar se çfare planesh ka Bashkia për zhvillimin e qytetit e në veçanti u ka folur për ato projekte, të cilat kanë në qendër të tyre fëmijët. Ashtu siç votojnë këshilltarët për projektet që propozon bashkia, ashtu kanë votuar edhe nxënësit e vegjël për ndërtimin e një fushe sporti për ta. Nëpërmjet bashkëbisedimit dhe vizatimeve të hedhura në letër, nxënësit i shprehën Kryetarit të Bashkisë dëshirat e tyre, se si e duan dhe si e përfytyrojnë ata qytetin e tyre të dashur në të ardhmen.

"Menaxhimi i Mbetjeve Urbane" nën interesin e Ambasadorit Gjerman, Borchardt

"Në rast se do të arrihet të ndërtohet një model i mirë dhe i suksesshëm i fushës së mbetjeve urbane ashtu si ujësjellësi, kjo do të reflektohte në të gjithë Shqipërinë, për të zgjidhur një nga problemet më të mëdha që ne kemi, menaxhimi i mbetjeve urbane".

E një rëndësie të veçantë konsiderohet edhe ardhja e Ambasadorit Gjerman Borchardt, i cili brenda një kohe të shkurtër e viziton për herë të dytë Bashkinë e qytetit.

Ambasadori ka vlerësuar ecurinë e projekteve të financuara dhe të mbështetura nga investitorët dhe qeveria gjermane siç është ai i kanalizimeve

Më tej është biseduar për projektin më madhor jo vetëm për Korçën, por për të gjithë Shqipërinë Juglindore, siç është ai i menaxhimit të mbetjeve urbane, i pari i këtij lloji në vendin tonë.

Në këtë pikë Kryebashkiaku Peleshi dhe Ambasadori Borchardt ndanë mendimin se përgjegjësia e tyre për suksesin e zbatimit të këtij projekti është e madhe jo vetëm në raport me qytetarët korçarë, por edhe në raport me qytetarët e të gjithë Shqipërisë.

Memorandum për zhvillimin e projekteve të përbashkëta të së ardhmes

Bashkia e Korçës dhe ajo e Prilepit të Maqedonisë së bashku me Komunën e Liqenasit nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit, e cila konsiston në zhvillimin e projekteve të ardhshme dhe aktiviteteve me interes të përbashkët.



Ky memorandum ishte rezultat i iniciativës së organizatave joqeveritare si

palë e këtij memorandum, në kuadrin e projektit "Institucionalizimi i Rrjetit Ndërkufitar të Organizatave Joqeveritare në Eurorajonin e Prespës dhe Ohrit".

Palët nënshkruese të këtij memorandum morën përsipër që në të ardhmen të krijojnë kushtet për ingranimin e subjekteve të tjera të sektorit publik dhe privat, me qëllim mbështetjen institucionale dhe stimulimin e partneritetit mes qytetarëve, qeverisjes vendore dhe strukturave të tjera.

Supplement

Qefsere Trako
tek "Qyteti im"

Qefsere Trako tek “Qyteti im”

Kultura e një qyteti nuk ka të ardhme të shëndoshë pa vlerësuar të shkuarën

Qefsere Trako (Kushe) ka lindur në 23 Prill 1928.

E apasionuar pas teatrit që në moshën shkollë, Qefsere Trako ka qenë ndër gratë e para artiste të qytetit të Korçës. Me pjesëmarrjen e saj në veprimtaritë artistike dhe kulturore, ajo ka thyer tabutë e kohës. Ajo është një ndër 10 artistët, të cilët në vitet 1950 krijuan teatrin profesionist në Korçë.

Në rreth 30 vjet jetë skenike, Qefsere Trako, ka realizuar gati 80 role në teatër dhe disa role në kinematografi. Ajo gëzon titullin “Laureate e Festivalit Teatror Kombëtar”, me rolin e saj në dramën “Hijet e natës”, të Vedat Kokonës. Në 80 vjetorin e saj të lindjes Bashkia e Korçës i dha asaj titullin e lartë “Qytetar nderi”.

Qyteti im: Pas 80 vitesh jetë dhe gati një gjysëm shekulli në skenë, Korça ju ka “Qytetare nderi”. Si e përjetuat këtë vlerësim që ju bëri Bashkia e Qytetit?

Qefsere Trako: Kjo ka qenë gjëja më me vlerë në jetën time, e them me të vërtetë. Isha propozuar disa herë për titullin “Artiste e merituar”, e ky titull pas ndërhyrjeve keqdashëse ishte anuluar. Gati e kisha humbur besimin. Ky vlerësim i Bashkisë Korçë më ripërtëriu. Mendoj se kultura e një qyteti nuk ka të ardhme të shëndoshë pa vlerësuar mirë të shkuarën që është dhe themeli i saj. Ky titull ishte gëzimi më i madh në jetën time.

Qyteti im: Ju jeni një nga aktoret e para të këtij qyteti, madje një nga themelueset e teatrit profesionist. Por duke patur parasysh mentalitetin e atyre viteve, si je ndër të Qefsere përballë kohës në të cilën filllove rrugën e artit?

Qefsere Trako: Ishte një nga periudhat më të vështira për mua. Ajo që më trembte nuk ishte skena, por pas çdo shfaqjeje, thosha si do të kthehesha në shtëpi. Shumë njerëz nuk e aprovinin ngjitjen e një gruaje në skenë, megjithatë unë i kam përballuar me një vullnet të jashtëzakonshëm, fyerjet, të sharat, madje edhe gurët me të cilët “fanatikët” e kohës më gjuanin sapo unë dilja nga teatri.

Qyteti im: Si është bërë i mundur kontakti juaj i parë me teatrin?

Qefsere Trako: Artisti korçar Dhimitër Trajçe, asaj kohe regjisor, më ka afruar një rol tek “Dasma Korçare”, pjesa e parë dramatike e vënë në skenë në këtë qytet me aktorë të rinj. Kisha shumë dëshirë, por nuk mund të luaja e vetme. Luajta së bashku me dy shoqet e mia Valentina dhe Vangjeli Kolevica (Pikulji). Ky ka qenë roli im i parë si amatore, por dëshirën e kam patur që fëmijë.

Qyteti im: Shumë femra bashkëkohëse me ju që hynë në rrugën e artit sakrifikuan jetën e tyre. Të vlerësuar si jo të moralshme ato nuk mundën dot të krijonin familjet e tyre. Po të mos njiheshit me bashkëshortin tuaj Vanin që gjithashtu ishte artist, a do të kishte qenë e vështirë edhe për ju?

Qefsere Trako: Kur i hyra rrugës së artit nuk e mendova çfarë pasojash do kishte për mua. Unë doja vetëm të luaja teatër, të ngjitesha në skenë përballë spektatorit. Njohja me Vanin ka qenë fat sigurisht dhe sidomos kur luaja me të, dëshira për teatrin më shtoi.

Qyteti im: Më pas u bëtë familjare. Ka qenë e vështirë për Qefseren të gjejë një raport të drejtë mes të qenit bashkëshorte, nënë dhe aktore?

Qefsere Trako: Shumë e vështirë, pasi në ato vite edhe turnetë ishin të shumta, por më ka ndihmuar shumë bashkëshorti dhe nëna e tij.

Qyteti im: Cilin nga rolet tuaja do të veçonit?

Qefsere Trako: Të gjitha rolet i kam dashur njësoj, por roli tek drama “Hijet e natës”, është i veçantë, mbase edhe prej vlerësimit të dhënë në një Festival

Kombëtar. Artistit i pëlqen të vlerësohet.

Qyteti im: Nga regjisorët me të cilët keni punuar, cilët do të veçonit?

Qefsere Trako: Pa dyshim Sokrat Mion. Punova rreth 20 vjet me të. Më pas kam punuar me Pirro Manin, Mihallaq Luarasin etj. Ata i kanë dhënë shumë Korçës dhe kanë bërë që Teatri i Korçës të ishte në krye.

Qyteti im: Teatri dje dhe sot. Duke jetuar në periudha të ndryshme, e duke qenë protagoniste e fillesave të teatrit në këtë qytet ç’mund të thoni?

Qefsere Trako: Në ato vite kur ne filluam t’i jepnim udhë teatrit, spektatorët mezi prisnin të shihnin një shfaqje. Si rezultat i kërkesave të mëdha nga ana e spektatorëve, çdo shfaqje jepej 70-80 herë, madje disa shfaqje janë dhënë 150 herë. Ne luanim dhe priteshim me duartrokitje. Sot koha ka ndryshuar. Njerëzit kanë forma të tjera argëtimi dhe teatri duket se ka kaluar në plan të dytë. Megjithatë besoj se shfaqjet cilësore dhe me nivel edhe sot e afrojnë spektatorin tek teatri.

Qyteti im: Do të donit që të kishte më shumë vlerësime për ju artistët e vjetër dhe pse jo të aktivizoheshit më tepër në jetën kulturore të qytetit?

Qefsere Trako: Patjetër që po. Do të na mbanin gjallë, do të na ripërtërinin, siç ndodhi me këtë vlerësim që më bëri mua Bashkia e Korçës, e për të cilin edhe njëherë e them i jam mirënjohëse.

Mbase duhet të isha vlerësuar edhe më parë, si edhe koleget e mia, që kanë hyrë më vonë se unë në teatër, e kanë luajtur më pak role. Por kjo ka pak rëndësi. Nëse një Bashki krahas punës dhe kujdesit që tregon për qytetarët e saj, vlerëson edhe të shkuarën e qytetit, meriton vendin dhe detyrën që ka.

Qefsere Trakos i jepet titulli i lartë “Qytetare nderi” me motivacionin:

“Për merita të shquara si aktore në interpretimin e roleve në teatër dhe kinematografi, si një nga gratë e para artiste në thyerjen e barrierave dhe mentaliteteve të kohës, që me punën e saj të palodhur ka lënë gjurmë në kulturën e qytetit të Korçës dhe asaj Kombëtare”

Role në teatër:

Eliza – Kopraci
Iazgol - Nderi i Familjes
Ksenja –Përmbysja
Zonja Kote – 14 vjeç dhëndër
Frosina – Dashuria e madhe
Beatrice –Gënjeshitari
Belina – I sëmuri për mend
Martina – Doktorja pa dashka etj.

Ka interpretuar në filmat:

- Tana
- Përballimi
- Rrugicat që kërkonin diell
- Mësonjëtorja
- Yjet e netëve të gjata



Vështrim në Kohë

Vijon nga numri i kaluar

Iliaz Beu ishte me origjinë shqiptare nga fshati Panarit me emrin Ilia. Duke shërbyer në ushtrinë turke Iliazi mundi të fitojë ofiqe e grada dhe të bëhet një nga funksionarët e Perandorisë Osmane me titullin Goxha Mirahorit (komandant i stallave të sulltanit). Në mylukun e tij, ai ndërtoi një xhami të madhe në vitin 1496, e cila ruhet edhe sot, një imaret me të gjitha lokalet e nevojshme si kuzhinë, depo, furrë të cilat së bashku me fshatin Peshkopi dhe me pronat e tjera të tij nga fundi i jetës, më 1505, i ktheu në vakëfe. Iliaz Bej vdiq më 1500 dhe u varros afër Xhamisë së Madhe.

Nga shek. XVII vijnë dy njoftime. Nga një dokument i viteve 1647-1648 mësojmë se tregëtarët elbasans për të shkuar në Venetik në kohën e luftës veneto-turke (1644-1669), ndiqnin rrugën e gjatë e me shumë stacione Elbasan-Korçë-Sarandë-Korçë-Venetik. Gjatë rrugës ata blinin në Korçë prodhime blegtorale, zejtare dhe shisnin prodhime manufakture të sjella nga Venetiku. Njoftimi i dytë vjen nga Kodiku i Mitropolisë së Korçës i cili bën fjalë për datën e themelimit të Kodikut në vitin 1676 nga Kryepeshkopi i Justinianës së parë të Ohrit, Parthenit nga Korça, i cili le të kuptohet se Korça në këtë kohë ishte qendër peshkopate dhe kishte mitropolinë e saj. Në fillim të shek.XVIII Korça duhet të ketë pasur rënie. Mesi i shek.XIX e gjeti Korçën një qytet në lulëzim e sipër, që tërhiqte gjithnjë e më tepër banorë të ardhur nga fshatrat përreth. Në vitin 1859 Korça numëronte 10.000 banorë, ritmet e shtimit të popullsisë pas kësaj periudhe bëhen të përshpejtuara. Në vitin 1923 arriti të ketë 25.598 banorë e të jetë qyteti më i madh i Shqipërisë. Por ky numër kaq i lartë ka përfshirë dhe shtesën e popullsisë së fshatrave të djegur gjatë luftave ballkanike e botërore që gjeti strehë në Korçë, sepse më 1927 qyteti numëronte 19.491 banorë, numër të cilin me ndryshime të pakta e ruajti deri në prag të Çlirimit. Siç vumë në dukje më sipër, Korça në fillimet e saj ishte qendra administrative e krahinës përreth, shkallë-shkallë, duke u fuqizuar ekonomikisht dhe politikisht më 1827 bëhet Kajmekanllëk (Nënprefekturë), ndërsa më 1870 arrin të kthehet në Mytesarifllëk (Prefekturë), që kishte nën varësi Nënprefekturat e Kosturit, Bilishtit e të Kolonjës.

... vazhdon në numrin e ardhshëm

Shënim: Të dhënat historike dhe hipotezat e paraqitura në këtë artikull nuk prezantojnë një qëndrim zyrtar të stafit të gazetës.



Burime:

LIBRAT:

- “Fjalori enciklopedik shqiptar”, Tiranë, 1985
- “Korça, në faqet e historisë”, Emin Selenica
- “Një faqe historike”, Nikollaq Zoi, Korçë, 2000
- “Korça - urbanistika, arkitektura”, Piro Thomo
- “Mbi themeliomin e Korçës” (broshurë) Arben Gjata
- “Shqipëria më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
- “Shqipëria e ilustruar më 1928”, Teki Selenica, Tiranë, 1928
- “Korça dhe fshatrat përfaqar”, Nuçi Naçi, Sofje, 1901
- “Korça dhe katundet e qarkut” (ribotim i plotësuar), Nuçi Naçi, Korçë, 1923
- “Historia e Shqipërisë” vëll. II, Tiranë 1965
- “Themistokli Gërmenji”, Piro Tako, Tiranë, 1988

GAZETAT:

- (Koleksione pranë Bibliotekës “Thimi Mitko” dhe Bibliotekës Kombëtare Tiranë)
- “Korça” drejtuar nga Sami Pojani e Lytfi Zavalani, Korçë, 1908-1910
- “Lidhja othodokse”, drejtuar nga Mihal Grameno, Korçë, 1909
- “Koha” drejtuar nga Mihal, Mina e Koço Grameno, Korçë, 1911-1926
- “E drejta”, drejtuar nga Leonidha Naçi, Korçë, 1924
- “Gazeta e Korçës”, drejtuar nga Zhan Gorguzi. Koleksion i viteve 1930-1935

Pazari i Korçës, pjesa më e madhe e të cilit ka arritur deri në ditet tona në gjendje pak a shumë origjinale dhe me të gjitha pjesët përbërëse të tij, është një shembull me mjaft interes i ansambleve tregtaro-zejtare, pazareve, jo vetëm për qytetin e tij që e rriti dhe e fuqizoi, por zë gjithashtu dhe një vend të rëndësishëm në ansamblet e pazareve në mbarë qytetet ballkanike.

Në strukturën urbanistike të qytetit, pazari formonte një ansambël më vete, të shkëputur nga lagjet e banuara. Për pamjen fillestare të pazarit kemi vetëm të dhëna të tërthorta. Në Kodikun e Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit janë regjistruar kronikat të tre zjarreve të fuqishme që e shkretuan atë herë pas here, në vitin 1822, 1858 dhe në vitin 1879. Këto kronika për përsëritjen e shpeshtë të zjarreve na lenë të supozojmë që ndërtimet e pazarit kanë qenë të ndërtuara me

Pazari i Vjetër i Korçës



materiale të brishta, ku druri do të ketë qenë materiali kryesor.

Me rritjen e veprimtarisë ndërtimore të qytetit dhe i detyruar nga shkaqet madhore, siç ishin zjarret e përsëritura shpesh, filloi dhe rikonstruksioni i pazarit rreth mesit të shek. të XIX. Ashtu si për qytetin, edhe për pazarin u zbatuan kriteret urbanistike dhe arkitektoniko-konstruktive të reja.

Qendrën kompozicionale të pazarit e përbënte një shesh i madh e i hapur, që quhej Pazar i Madh, ku tregtohej pjesa më e madhe e prodhimeve bujqësore e zejtare. Rreth kësaj qendre kompozicionale ngriheshin ndërtimet e tjera në Pazar.

Vijon numrin e ardhshëm

Projekti i Pazarit të Korçës – Para Ekspertëve të Këshillit Europian

Projekti për rivitalizimin e pazarit të vjetër të Korçës është prezantuar për ekspertët e Këshillit të Europës nga Arkitekti Spiro Thomo.

Përmes imazheve të pazarit të dikurshëm dhe fakteve historike, është prezantuar gjithë aktiviteti tregëtar, ndikimet dhe lidhjet me kryeqendrat e rajonit, të Europës dhe deri në Amerikën e largët si dhe lulëzimi i mjaft zejeve të kohës.

Ky pazar me vlera të padiskutueshme arkitektonike të ruajtura edhe në ditët e sotme, një trashëgimi historike për qytetin është një vlerë e veçantë e tij. Ndaj Bashkia e Korçës kërkon t'i kthejë atij sharmin e dikurshëm, duke e rivitalizuar nga ana arkitektonike, por njëkohësisht kërkon ta shndërrojë atë në një qendër komerciale dhe të vizitueshme nga turistët.



Dostojevski në skenën korçare

Dostojevsi, ky mjeshtër i madh i shpirtave njerëzorë, vjen për herë të parë në skenë për spektatorin korçar nga Artisti i Merituar Llazi Sërbo përmes monodramës “Sirius”, sipas novelës “Ëndrra e një njeriu qesharak”. Monodrama që u përcoll më së miri nga aktori Andrea Pepi në rolin e njeriut qesharak, i shoqëruar nga Benedeta Pavliqoti, në rolin e ëngjëllit mbrojtës, krijoi emociione në rritje për spektatorët e pranishëm në sallën e Katedrales së qytetit.

Mesazhet e veprës: Të duam njëri –tjetrin si veten; lufta për të vërtetën si dhe urrejtja e përbuzja ndaj gënjeshtërs; bindja dhe shpresa se mençuria, vetpërmbytja dhe arsyeja do të triumfojnë; gjithë parajsja nuk vlen sa loti i një fëmije, janë akoma aktuale edhe sot.

Vënia në skenë e veprës u mundësua nga Bashkia Korçë dhe Qendra Kulturore “V.Mio, me mbështetjen e biznesit Korçar. Monodrama “Sirius” që u shfaq për spektatorin disa ditë rresht, u ndoq nga përfaqësues të pushtetit lokal, artistë, dashamirës të artit e të skenës. Midis të ftuarve ishte edhe Atasheu Kulturor i Ambasadës Ruse në Tiranë Ilia Uvorov. Me iniciativën e organizatorëve, secili sipas mundësive financiare ka kontribuar në arkën e Katedrales “Ngjallja e Krishtit” për fëmijët në nevojë dhe në veçanti ata romë.

Skenograf: G. Proko, Kostumograf: S.Kuqali, Përktheu: A. Ballauri, Koreografi: A. Bratko, B. Pojani, Fonia: P.Gjata



“Mitet Greke dhe Antikiteti” nga Vasillaq Kolevica

Ekspozita me punime të qeramikës e skulptorit Vasillaq Kolevica e titulluar “Mitet greke dhe antikiteti” shënoi prologun e Panairit Ndërajonal të Poçerisë, të organizuar nga Bashkia Korçë. Ekspozita e skulptorit Kolevica dalloi për përzgjedhjen me mjaft kujdes të historisë më të spikatur të periudhës së antikitetit dhe mitologjisë greke. Ajo përfshiu monedhat e përdorura në Greqinë e lashtë, mendimtarët dhe filozofët e mëdhenj të saj, deri tek krijimet nudo me mjaft imagjinatë dhe sensualitet. Në këto punime nuk munguan edhe trajtimi i temave filozofike.

Krahas motiveve e figurave nga mitologjia greke një pavion i veçantë ishte rezervuar edhe për disa kompozime nga gjetjet në Tumën e Kamenicës të cilat janë krejtësisht autoktone pa influenca helenike.

Ekspozita, e cila qëndroi e hapur për një javë, u vizitua me mjaft interes nga një numër i madh njerëzish.

Spektakli Rinor

Teatri “Andon Z. Çajupi” si asnjëherë më parë u mbush nga të rinjtë e qytetit që krijuan një atmosferë festive, rinore, ndryshe nga çdo here tjetër.

Në spektaklin rinor të organizuar me 7 shkollat e mesme të qytetit, të rinjtë shfaqën talentin e tyre në gjinitë e aktrimit, kërcimit, interpretimit muzikor dhe prezantimit. Ky aktivitet, i pari i këtij lloji në qytetin tone ka qenë surprizuese përse i përket talenteve të reja ku në evidentimin dhe në përgatitjen e tyre punuan aktorët profesionistë të teatrit të Korçës dhe mësuesit. Shtatë shkollat pjesëmarrëse u prezantuan secili me nga një shfaqje. Në përfundim, juria, e drejtuar nga këngëtarja dhe aktorja Spanja Pipa, ka vlerësuar me çmimin e parë Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Faik Konica”, trofeun e së cilës e ka dorëzuar Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi. Njëkohësisht, tre artistët më të mirë u vlerësuan me tre çmimet e mëdha. Kështu, çmimin për instrumentistin më të mirë e ka merituar nxënësi i Shkollës së Mesme të Përgjithshme “Themistokli Gërmenji”, Beartin Koçibelli. Çmimin për këngëtarin më të mirë e ka marrë Atea Stiko, nxënëse në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Raqi Qirinxhi” dhe çmimi për aktrimin më të mirë i është dhënë Aleks Seitaj, nxënës në Shkollën e Mesme të gjuhëve të huaja “Faik Konica”. Bashkia, e cila ishte iniciatore e këtij projekti, kishte mbështetjen e Drejtorisë Rajonale Arsimore dhe të Teatrit A.Z. Çajupi.



“Maqedonia ime”, ekspozitë e fotografit Nikolla Pavleski

“Maqedonia ime” u titullua ekspozita fotografike e autorit maqedonas Nikolla Pavleski. Kjo është ekspozita e parë në Korçë e këtij autori e hapur me iniciativën e tij dhe e mbështetur nga Qendra Kulturore “V.Mio”. Në 70 fotot e ekspozuara mbizotëruan peisazhet nga Maqedonia, objekte kulturi, portrete e karaktere. Ekspozita i shërben vazhdimësisë së miqësisë e shkëmbimeve kulturore mes vendeve fqinje Shqipëri –Maqedoni. Ajo u vizitua nga përfaqësues



të komunitetit maqedonas në Korçë dhe dashamirës të artit të fotografisë.



Koncert i korit

Lira në Korinth të Greqisë

Me një ftesë të posaçme të shoqatës kulturoro-artistike “Miqësia 2008”, një shoqatë kjo shqiptaro –greke e porsakrijuar si dhe me iniciativën e Kryetarit të Bashkisë së Korinthit Kosta Filipidhis, Kori “Lira” dha një koncert në Korinth të Greqisë. Kjo ishte një përshëndetje miqësore mes dy popujve tanë, ku Shqipëria u përfaqësua denjësisht me Korin “Lira”. Në këtë aktivitet morën pjesë drejtues të pushtetit vendor, kryetarë shoqatash greke, miq e dashamirës të popullit shqiptar. Koncertin e ndoqi nga afër Ambasadori Shqiptar në Athinë z. Vili Minarolli. Koncerti u ndoqi nga 700 vetë, çka shënoi numrin më të madh të të pranishëmve në sallë.

Rikonstruksioni i stadiumit të qytetit



Pas një kontrate me FSHF-në, Bashkia e qytetit së bashku me Shoqatën e Futbollit ka filluar punën për rikonstruksionin e fushës së Stadiumit “Skënderbeu”. Aktorët lokalë do të kryejnë të gjitha punimet e nëntokës, sistemin vaditës dhe nivelimin e fushës deri në hedhjen e shtresës së dheut, ndërsa FSHF do të shtrojë tapetin e gjelbër. Me një investim total prej 25 milion lekësh fusha e degraduar, e cila nuk njeh një investim të tillë qysh prej vitit 1984, pritet të ketë standartet ndërkombëtare, sipas kushteve që kërkon FIFA e UEFA. Kryetari i Bashkisë, Niko Peleshi, pohon se arritja e këtij standarti në infrastrukturë, do të pasohet me një rikonceptim total të të gjithë strategjisë për futbollin e sportin në përgjithësi. Pjesë e kësaj strategjie është edhe krijimi i një shkolle, e cila do të përzgjedhë talentet e spikatur në disiplina të ndryshme të sportit. Kjo shkolle do të mbushë ekipet zinxhirë me lojtarë korçarë që do të jenë baza e ekipit, të cilët do të përbëjnë garancinë për të arritur rezultatet e dëshiruara.

Klubi shumësportësh

“Strategjia e Klubit Shumësportësh është rinovimi i mentalitetit dhe metodave në drejtimin e ekipeve si dhe ulja e moshës së sportistëve”
Tatjana Marashi –Sekretare e Klubit Shumësportësh


Ekipi i basketbollit për meshkuj rizgohet si asnjëherë tjetër me rikthimin e tre basketbollistëve korçarë që bashkohen pas 7 vitesh në qytetin e tyre, me mbështetjen e klubit si dhe të një grupi biznesmenësh korçarë. Ky ekip qëndron në krye të Grupit A2 duke na dhuruar herë pas here ndeshje spektakël e duke mbushur shkallët e Pallatit të Sportit me sportdashës.

Migena Panariti vazhdon me shumë ambicie të stërvitë ekipin e gjimnastikës aerobike dhe për të gjashtin vit rresht merr trofeun e Ekipit Kampion Kombëtar. Kështu, në garat individuale, statusin e kampionit kombëtar për të reja e mban Ediona Zyko, ndërsa për të rritura Isabela Panariti.

Ekipet e atletikës qëndrojnë në pararojë të Shumësportëshit Korçar. Në çdo aktivitet, përveç kampionëve të shumtë individualë, këto ekipe renditen në podin e fituesve. Shumë prej këtyre atletëve janë anëtarë të ekipit kombëtar për të gjitha grupmoshat. Është për tu vlerësuar fakti se për herë të parë vjen me një kontribut modest si trajnere nga Greqia emri më i madh i atletikës shqiptare, Pavlina Evro, e cila stërvit një grup atletësh shqiptarë, nga qyteti i Korçës, që do të përfaqësojnë qytetin në Kampionatin Kombëtar të këtij viti. Duhet



theksuar që Pavlina afrohet për qytetin e saj me shumë modesti dhe si asnjë trajner tjetër nuk vendos kushte financiare. Nënkampioni i Ballkanit për 800 m U-20, Andrea Kokoti, që stërvitet në Selanik, Greqi nga Pavlina Evro kësaj here do të garojë për Korçën.



8 grupe pune me përbërje nga institucione të ndryshme të qytetit, të cilët deri në fund të muajit Maj do të krijojnë inventarin bazë që do të shërbejë si një dokument themelor për hartimin e Planit Rregullues të qytetit.

3 sheshe ndërtimi në dispozicion të të pastrehëve

Bashkia Korçë është duke ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të zgjidhjes së problemit të strehimit. Aktualisht në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave janë vënë tre sheshe ndërtimi. E para është tek Deboja me një sipërfaqe prej 100 m² ku do të ndërtohen dy pallate të tipit “Banesa sociale me qera” për 96 familje. Një tjetër sipërfaqe ndodhet në Lagjen 18, tek Rruga “Th. Saro”, e cila është në administrim të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike. Këtu është parashikuar të ndërtohet një pallat me 40 apartamente të tipit “Banesa sociale me kosto të ulët”. Po kaq e rëndësishme është edhe Strategjia Kombëtare e qeverisë shqiptare për strehimin e familjeve rome, në të cilën është përfshirë edhe Korça. Bashkia ka vënë në dispozicion sheshin e ndërtimit tek Traverbangu në afërsi të Drenovës ku janë kryer edhe punimet inxhinierike. Parashikohet që këtu të ndërtohen apartamente për strehimin e 44 familjeve rome të evidentuara në listat e të pastrehëve që disponon Zyra e Strehimit në Bashkinë Korçë.



Kompjuterizimi i Gjendjes Civile

Në Bashkinë Korçë është duke u punuar për hedhjen e të dhënave të regjistrave themeltarë të gjendjes civile në soft. Ky është një projekt i Bashkimit European në bashkëpunim me OSBE, i cili konsiston krijimin e regjistrat elektronik të Gjendjes Civile sipas standarteve bashkëkohore. Krijimi i regjistrat elektronik do të çojë nga njëra anë në modernizimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe nga ana tjetër, ajo do t'i shërbejë pajisjes së qytetarëve me karta identiteti si dhe do të ndihmojë në krijimin e sistemit të adresave.

Hapi i parë drejt planit rregullues të qytetit

Pranë Bashkisë Korçë është ngritur grupi i punës për inventarizimin e të dhënëve, të cilat do t'i shërbejnë hartimit të Planit Rregullues të qytetit.

Plani Rregullues ekzistues, është hartuar qysh në vitin 1995 dhe nuk i përgjigjet ndryshimeve dhe kërkesave të një sistemi të ri ekonomiko-shoqëror në bazë të së cilit është prona private. Si rrjedhojë, qyteti i Korçës akoma nuk ka një inventar të tij. Në këto kushte, mbi bazën e një urdhëri të brendshëm të Kryetarit të Bashkisë, janë ngritur

Korça ku → dua të jetoj

Të jesh krenar për qytetin tënd!

Nëse jeni një i apasionuar pas fotografisë, kjo është mundësia jote. Dërgo foto të qytetit që të bën ty të ndihesh krenar për të.

Ne ju ftojmë të gjithëve të dërgoni foto nga ndërtesat, aktivitetet, festat apo çdo gjë tjetër që ju e keni përzemër, apo ju pëlqen ta shihni.

Çdo muaj, fotot më të mira do të publikohen në faqet e “Qyteti im” dhe në fund të vitit, ju do të keni mundësi të paraqisni punën tuaj në një ekspozitë enkas për ju, ku do të zgjidhet fotoja e vitit.

Kontakte:

Tel: 45755

e-mail: bashkiko@albmail.com

Bashkë me fotot dërgoni dhe një përshkrim të shkurtër të fotos dhe pse e keni zgjedhur pikërisht atë.





Përgatitën:

Ana Qeramixhi
Sofjola Kotelli
Mikel Llogori

Suplement

Benila Tërova

Ndihmuan:

Stafi i Bashkisë Korçë
Pallati i Kulturës “V.Mio”
Ndërmarja e Shërbimeve Publike
Teatri “A.Z.Çajupi”

Fotot nga:

Ana Qeramixhi
Donald Braholli
Vaskë Niço
Kristaq Sotir
Orieta Glozheni

Design:

R&T Advertising

Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një këthese ecim me vurr në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.

Mbështesni “Qyteti Im”



Për më tepër informacion:

Tel: 457-55

e-mail: bashkiko@albmail.com